Ndriçoje Botën

50 MËNYRA SE SI TA LËSH TË SHNDRITË DRITA JOTE

1. Jepja librin tënd të parapëlqyer një njeriu të dashur.
2. Dhuroji konserva ushqimesh bankës sate vendore të ushqimeve.
3. Buzëqeshi dikujt.
4. Lëri një shënim dashamirës postierit tënd.
5. Ftoje një fqinj në një shërbesë adhurimi.
6. Shikoje materialin filmik "Krishti Fëmijë" me familjen ose miqtë.
7. Lër një koment zemërdhënës në mediat shoqërore.
8. Vizito një fqinj të moshuar.
9. Dërgoji dikujt me mesazh në telefon fjalët: "Jam mirënjohës/e për ty".
10. Thuaji një njeriu të dashur se është i rëndësishëm për ty.
11. Ji i mirë me veten. Ushtroje kujdesin për veten.
12. Pastro mbeturinat në komunitetin tënd.
13. Dërgoji një shoku ose shoqeje një pamje gazmore ose material filmik për të qeshur.
14. Gatuaj një vakt ushqimor me një pjesëtar të familjes.
15. Shko të këndosh këngë Krishtlindjeje me një grup.
16. Bëj një shëtitje me një shok apo shoqe.
17. Ofrohu që t'i mësosh dikujt një zotësi të re.
18. Mbaje derën të hapur për një njeri të panjohur.
19. Organizo një mbrëmje lojërash me familjen.
20. Lutu për dikë me emër.
21. Jep kontribut vullnetar te biblioteka jote vendore.
22. Paguaj për personin pas teje në dyqan.
23. Përqafo një shok ose shoqe.
24. Fale dikë.
25. Ftoji të tjerët në një kremtim të Krishtlindjes.
26. Merre në telefon dikë për të cilin të ka marrë malli.
27. Mëso të thuash "Gëzuar Krishtlindjen" në një gjuhë të re.
28. Merr edhe një ushqim tjetër të vogël me vete për dikë në nevojë.
29. Dërgoji një kartolinë Krishtlindjeje të bërë vetë një shoku ose shoqeje.
30. Planifiko që të kalosh kohë vetëm për vetëm me një njeri të dashur.
31. Lëre një të panjohur të kalojë përpara teje në radhë.
32. Ji i duruar me kamerierët dhe personelin e shërbimit.
33. Jep kontribut në Makineritë e Dhurimit në vendin tënd ose në internet.
34. Dërgoji një fotografi të një kujtimi të bukur një pjesëtari të familjes.
35. Mëso se si e festojnë Krishtlindjen në kultura të tjera.
36. Plotëso një detyrë në listën e gjërave që duhet të bëjë një njeriu yt i dashur.
37. Pyet një koleg se si mund t'ia lehtësosh barrën.
38. Publiko një shënim për një njeri të dashur duke përdorur thurjen #NdriçojeBotën.
39. Shpërnda një hallkë lidhëse të një kënge festive që të pëlqen.
40. Ndihmoje dikë që të hulumtojë gjenealogjinë e familjes së vet.
41. Bëj një listë me këngë Krishtlindjeje dhe tregoja një shoku ose shoqeje.
42. Dërgoji një pusullë falënderimi një punonjësi të kujdesit shëndetësor.
43. Ndalu që të ndihmosh dikë që po has probleme me makinën.
44. Lër një dhuratë te dera e një fqinji.
45. Përkrah një biznes të vogël vendor.
46. Bëji një kompliment fqinjit tënd.
47. Lejoje dikë tjetër që të jetë dashamirës ndaj teje.
48. Ndihmoje një njeri të dashur që të pastrojë shtëpinë e vet.
49. Kërkoji falje dikujt.
50. Qesh me një shok ose shoqe.



KISHA E JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË DITËVE TË MËVONSHME

© 2023 by Intellectual Reserve, Inc. All rights reserved. 101 Albanian.